

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një kompani shqiptare me një game të gjere dhe të diversifikuar biznesi. Portofoli kryesor i veprimtarive të Gener 2 konsiston në ndertimin e objekteve rezidenciale, komerciale dhe industriale si edhe infrastrukture dhe ndertim rrugesh. Pjesë e rendesishme e portofolit të investimeve të Gener 2 janë dhe Njesite tregtare si: Qendra Tregtare Toptani, ABA Business Center dhe COIN, ABA 21 Fine Restaurant, Fusion Dining & Cocktails.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Oficer QAQC në Qukes

❖ PERSHKRIMI I POZICIONIT

Oficeri i Sigurimit dhe Kontrollit të Cilesise ka përgjegjësi për implementimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Cilesise, si edhe sigurohet që instalimet në kantier të jenë në përputhje me Politikën e Cilesise së kompanisë bashkë me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe kërkesat e klientit.

❖ DETYRAT KRYESORE

- Zbaton Planin e Cilesise dhe Planet e Kontrollit dhe Inspektimit në Kantier;
- Paraqet këshilla për inspektim grupit të Zbatimit e Projektit mbi çështje të cilesise;
- Vendos dhe mirëmban mardhenie të mira me Klientin dhe oficeret e tyre;
- Kujdeset që aktivitetet ndërtimore të nenkontraktoreve të kryehen në cilesine e duhur në kohën e duhur;
- Sigurohet që të gjitha dokumentat në lidhje me projektin janë të azhurnuara dhe të disponueshme për inspektim;
- Identifikon problematikat në kantier përse i përket cilesise në materiale dhe puntori;
- Pret materialet e ardhura në kantier dhe sigurohet që ato të jenë sipas specifikimeve teknike dhe atyre të përzgjedhur nga kompania;
- Zhvillon aktivitetet sipas planeve të inspektimit (pritje, në proces dhe në fazë finale);
- Raporton në baze ditore për aktivitetet e cilesise në kantier;
- Asiston dhe drejton investigim në terren në prani dhe të Kordinatorit të cilesise;
- Kordinon, kontrollon dhe shpërndan të gjithë dokumentacionin të cilesise;
- Monitoron të gjitha aktivitetet e cilesise në projekt;
- Asiston në të gjitha auditet e brendshme dhe të jashtme të kompanisë;
- Asiston në mbledhjet e cilesise që organizojnë klientet (në kantier);
- Merrret me korrespondencën hyrje/dalje të cilesise përfshirë dhe shpërndarjen e Kërkesave për Inspektim;
- Raporton problematikat me kthimet dhe mospranimet dhe ndjek NCR të hapura mbi materialet;
- Raporton statistika;
- Asiston në përgatitjen e të gjithë dokumentacionit përmbylles së projektit;
- Ndjek Raportet e Jo Konformitetet;
- Monitoron dhe bashkëvepron me eprorin;
- Zbaton dhe mirëmban, monitoron dhe ndjek, rregjistrat duke përfshirë këtu Inspektimin e Materialeve, Jo-Konformiteteve/Masave Korrigjuese, etj.
- Përgatit raportin e progresit javor/mujor/vjetor.
- Kordinon testimet në kantier

❖ KRITERET KRYESORE

- Master Niveli i Pare ne Inxhinieri/ Universiteti Politeknik i Tiranes/ Fakulteti i Inxhinierise se Ndertimit;
- Njohuri te mira te gjuhes angleze;
- Mbi 3 vite experience pune ne pozicion te ngjashem ne fushen e ndertimit;
- Njohuri te programeve kompjuterike, Microsoft Office/AutoCad, Microsoft Office Project;
- Te jete i gatshem te punoje jashte Tirane.

Te gjithë te interesuarit, jane te lutur qe te dergojne CV nepermjet adreses se e-mailit careers@gener2.al ose te plotesojne formularin e aplikimit ne faqen zyrtare www.gener2.al ne seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit eshte **data 19 Janar 2018, ora 17:00**.

* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi “Mbrojtjen e të dhënave personale